



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 14/10/2024

Nr. 2968

Lënda: Përcillet për mendim projekudhëzimi i përbashkët

Drejtuar: Z. ERVIN HOXHA
MINISTËR I BRENDSHËM
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nd. 1, Tiranë 1001.

I nderuar,

Në mbështetje të ndryshimeve më të fundit të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, kemi nisur punën përgatitore për mundësimin e zgjedhjeve nga jashtë vendit për zgjedhjet e ardhshme për Kuvend të vitit 2025.

Në zbatim të nenit 25, pika 13 të Kodit Zgjedhor do të duhet të përcaktojmë me akt të përbashkët mënyrën e bashkëpunimit mes Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për ç' regjistrimin e shtetasve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga lista e zgjedhësve brenda vendit.


Përsa më sipër, gjeni bashkëngjitur për mendim dhe në vlerësimin tuaj projektudhëzimin e hartuar nga administrata.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri |



| info@kqz.gov.al | kqz.gov.al | +355 4 451 7810





MINISTRIA E BRENDSHME

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Nr. _____ datë _____

Nr. _____ datë _____

UDHËZIM I PËRBASHKËT

PËR MËNYRËN E BASHKËPUNITIT MES KQZ DHE DPGJC PËR Ç'REGJISTRIMIN E SHTETASVE QË VOTOJNË JASHTË VENDIT NGA LISTA E ZGJEDHËSVE BRENDIA VENDIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të paragrafit 2 të nenit 19, të nenit 25, të pikës 3 të nenit 46, dhe nenit 50 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

UDHËZIJMË:

I. Rregulla të përgjithshme

1. Zgjedhësi që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet e radhës për Kuvendin duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është një listë e vetme në nivel zone zgjedhore dhe përmban listën e shtetasve shqiptarë që kanë shprehur vullnetin të votojnë nga jashtë vendit dhe që janë regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile në territorin e zonës zgjedhore përkatëse.
3. Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë hartohet dhe përdoret rishtazi për çdo palë zgjedhje për Kuvendin sipas kriterëve, procedurave dhe afateve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore të KQZ-së të nxjerra në përputhje me të, dhe janë të vlefshme vetëm për zgjedhjet të cilat ato janë hartuar. Në çdo rast, KQZ dhe DPGjC ruajnë bazën e të dhënave të zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për çdo palë zgjedhje.

Data: dd mmvvvv Nr:
Ora: hh:mm




Për mënyrën e bashkëpunimit mes KQZ-së dhe DPGjC-së për ç'regjistrimin e shtetasve që votojnë jashtë vendit në listën e zgjedhësve brenda vendit.

4. Adresa e shtetasit që voton nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mbështetet në një nga dokumentet që paraqet në KQZ sipas pikës 5 të neni 25 të Kodit Zgjedhor.

II. Mënyra e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me qëllim ç'regjistrimin e shtetasve që votojnë jashtë vendit nga lista e zgjedhësve brenda vendit.

1. Regjistrimi i zgjedhësve nga jashtë vendit dhe përgatitja e listës së këtyre zgjedhësve bëhet sipas rregullave të përcaktuara me akt normativ të Komisionit Rregullator.
2. Kërkesat për regjistrim kryhet përmes Platformës Elektronike të Regjistrimit (këtej e në vijim referuar si PER), sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor.
3. Gjatë periudhës së hartimit të listës së zgjedhësve jashtë vendit, KQZ komunikon me DPGjC përmes ndërveprimit automatik elektronik në kohë reale të PER me RKGjC.
4. Të dhënat e identitetit të shtetasit të marra gjatë procesit të paraqitjes së kërkesës për regjistrim prej tij në PER, verifikohen nga KQZ-ja në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe, nëse ato janë të njëjta, bëhet nga DPGjC-ja regjistrimi në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile i adresës së shtetasit që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në një rubrikë të veçantë.
5. Të dhënat për adresën e banimit që do të kërkohen gjatë procesit të regjistrimit nga ana e zgjedhësit e që do të transmetohen në RKGjC janë: shteti, kodi postar, qyteti, emërtesa e rrugës, numri i banesës, elemente të tjera të adresës (nëse ka).
6. Çdo informacion që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve transmeton tek Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile si pjesë e procedurave për të përgatitur listën e shtetasve nga jashtë, do të përdoren nga DPGjC vetëm për qëllime që lidhen me mundësimin e votimit nga jashtë.
7. Në përfundim të procesit të regjistrimit të kërkesave të zgjedhësve për të votuar nga jashtë vendit, sipas afateve të përcaktuara me vendim të Komisionit Rregullator, DPGjC nxjerr nga RKGjC listën paraprake të zgjedhësve nga jashtë vendit dhe ia dërgon atë në format elektronik Komisionit Qendror të Zgjedhjeve jo më vonë se 63 ditë para datës së zgjedhjeve.
8. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, 63 ditë përpara datës së zgjedhjeve, publikon listën paraprake të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit, me qëllim që zgjedhësit brenda 48 orësh nga publikimi i saj të mund të kërkojnë regjistrimin apo rregullimin e pasaktësive të regjistrimit të tyre në PER. Informacioni mbi kërkesat e ardhura brenda këtij afati do të trajtohen në të njëjtën mënyrë si ajo e përmendur në pikën 3 të Kreut II të këtij Udhëzimi.
9. Në përfundim të procesit të përmendur në pikën 7 të Kreut II të këtij Udhëzimi, DPGjC nxjerr nga RKGjC listën përfundimtare të zgjedhësve nga jashtë vendit dhe ia dërgon atë në format elektronik Komisionit Qendror të Zgjedhjeve menjëherë, por jo më vonë se 61 ditë përpara datës së zgjedhjeve.
10. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, 60 ditë para datës së zgjedhjeve, miraton dhe publikon në faqen zyrtare të internetit të KQZ listën përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit.
11. Shtetasit shqiptarë që janë regjistruar në listën e zgjedhësve jashtë vendit, pas përfundimit të procedurës së regjistrimit sipas këtij vendimi dhe miratimit e publikimit të listës përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit nga Komisioneri Shtetëror i

Data: dd mmvvvNr:
Ora: hh:mm



Për mënyrën e bashkëpunimit mes KQZ-së dhe DPGjC-së për ç'regjistrimin e shtetasve që votojnë jashtë vendit në listën e zgjedhësve brenda vendit.

- Zgjedhjeve, çregjistrohen nga lista e zgjedhësve brenda vendit që shpallet sipas nenit 56 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
12. DPGjC dhe zyrat e gjendjes civile marrin masa për reflektimin e ç’regjistrimit të këtyre zgjedhësve nga lista e zgjedhësve brenda vendit në ekstraktin më të parë të listës së zgjedhësve që del pas miratimit e publikimit të listës përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

III. Mbikqyrja dhe kontrolli i procesit

1. Auditët teknikienë të miratuar sipas nenit 61, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, kryejnë verifikimin e veprimeve të realizuara nga KQZ për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë vendit duke filluar nga 120 ditë nga data e zgjedhjeve.

IV. Dispozita të fundit

1. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi administrata e Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, kryetarët e bashkive, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi administrative, si dhe institucionet e tjera shtetërore të parashikuara nga Kodi Zgjedhor
2. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.


Ministri

Ervin HOXHA

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: dd mmvvvNr:
Ora: hh:mm



Për mënyrën e bashkëpunimit mes KQZ-së dhe DPGjC-së për ç’regjistrimin e shtetasve që votojnë jashtë vendit në listën e zgjedhësve brenda vendit.